

Deputeti boshnjak në Kuvendin e Serbisë, Enis Imamović, reagon ndaj pritjes shtetërore që i është bërë gjeneralit të dënuarit nga Tribunali i Hagës, Vladimir Lazareviq.

Në fjalimin e tij ai numëron krimet e Lazareviqit dhe të Serbisë të kryera në Kosovë.

“Çfarë duhet të presin shqiptarët dhe boshnjakët, pas shpenzimit të parave të qytetarëve për pritje të kriminelëve të luftës?”, tha ai, dhe i ndërpritet fjalimi, transmeton Telegrafi.

Imamović edhe më herët në këtë Kuvend ka përmend vrasjet dhe dhunën që nuk zgjidhet në Serbië e keqbërësit që nuk ndëshkohen. Ndërsa, nuk harroi edhe kërcënimet e çetnikëve, “qenve të luftës”, të mercenarëve prorusë në Ukrainë, që po ia bënin Sanxhakut.

Ndër të tjera, vitin e kaluar ai kishte përmendur përmend edhe fashizmin serb, në Vojvodinën shumetnike, me sulmet ndaj pronës dhe jetëve të shqiptarëve.

Lazareviq ka qenë i akuzuar bashkë me gjeneralët serbë Nebojša Pavković, Sreten Lukić dhe Vlastimir Gjordjević, për përgjegjësinë komanduese dhe për dëbimin e shqiptarëve nga Kosova.

Ai ishte dënuar me 15 vjet burgim, mirëpo pas shqyrtimit të ankesës së tij dhe të avokatëve, dënimi i është zbutur për një vit.

Lazareviq për të përditshmen serbe “Politika” ka thënë se “nuk e di përse i ka humbur 10 vite të çmuara të jetës së tij”.

Atij në Serbi i ishte organizuar pritje nga krerë të lartë të shtetit. /Telegrafi/

//

Deputeti boshnjak në Kuvendin e Serbisë, Enis Imamović, reagon ndaj pritjes shtetërore që i është bërë gjeneralit të dënuarit nga Tribunali i Hagës, Vladimir Lazareviq. Dhe, numëron krimet e tij dhe të Serbisë të kryera në Kosovë. “Çfarë duhet të presin shqiptarët dhe boshnjakët, pas shpenzimit të parave të qytetarëve për pritje të kriminelëve të luftës?”, tha ai, dhe i ndërpritet fjalimi. DETAJET: <http://telegra.fi/qlimVz>

Posted by [Telegrafi.com](http://Telegrafi.com) on Saturday, December 12, 2015